

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 505

KONFIRMIMET NGA TË TRETËT

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Procedurat e konfirmimit nga të tretët për të siguruar evidencën e auditimit	2-3
Hyrja në fuqi	4
Objektivi	5
Përkufizimet	6
Kërkesat	
Procedurat e konfirmimit nga të tretët	7
Moslejimi nga drejtimi që audituesi të dërgojë kërkesën për konfirmim	8-9
Rezultatet e procedurave të konfirmimit nga të tretët	10-14
Konfirmimet negative	15
Vlerësimi i evidencës së përfutur	16
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Procedurat e konfirmimit nga të tretët	A1-A7
Moslejimi nga drejtimi që audituesi të dërgojë kërkesën për konfirmim	A8-A10
Rezultatet e procedurave të konfirmimit nga të tretët	A11-A22
Konfirmimet negative	A23
Vlerësimi i evidencës së përfutur	A24-A25

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 505 “Konfirmimet nga të Tretët” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) ka të bëjë me përdorimin nga audituesi të procedurave të konfirmimit nga të tretët, për të siguruar evidencën e auditimit në përputhje me kërkesat e SNA 330¹ dhe SNA 500². Ai nuk trajton kërkesat në lidhje me çështjet gjyqësore dhe pretendimet, të cilat janë trajtuar në SNA 501³.

Procedurat e konfirmimit nga të tretët për të siguruar evidencën e auditimit

2. SNA 500 tregon se besueshmëria e evidencës së auditimit ndikohet nga burimi dhe nga natyra e saj, dhe varet nga rrethanat individuale në të cilat është marrë.⁴ Gjithashtu, ky SNA përfshin edhe përgjithësimet e mëposhtme të zbatueshme për evidencën e auditimit:⁵
 - Evidenca e auditimit është më e besueshme kur ajo është marrë nga burime të pavarura jashtë entitetit.
 - Evidenca e auditimit që sigurohet drejtpërdrejt nga audituesi është më shumë e besueshme se sa evidenca e auditimit që sigurohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet konkluzioneve.
 - Evidenca e auditimit është më e besueshme kur ajo ekziston në formë dokumentare, qoftë në letër, në formë elektronike apo edhe përmes një mjeti tjetër.

Në përputhje me rrethanat e auditimit, evidenca e auditimit në formën e konfirmimeve, e marrë nga audituesi drejtpërdrejt prej palëve të treta, mund të jetë më e besueshme se evidenca e krijuar brenda entitetit.

Ky SNA ka për qëllim të ndihmojë audituesin në hartimin dhe kryerjen e procedurave të konfirmimit nga të tretët për të përfutur evidencën përkatëse dhe të besueshme të auditimit.

3. SNA të tjera njohin rëndësinë e konfirmimeve nga të tretët si evidencë auditimi, për shembull:

¹ SNA 330, *Reagimet e Audituesit ndaj Rreziqeve të Vlerësuar*.

² SNA 500, *Evidenca e Auditimit*.

³ SNA 501, *Evidenca e Auditimit-Konsiderata të Veçanta për Zëra të Zgjedhur*.

⁴ SNA 500, paragrafi A5.

⁵ SNA 500, paragrafi A31.

KONFIRMIMET NGA TË TRETËT

- SNA 330 trajton përgjegjësinë e audituesit për të përcaktuar dhe zbatuar veprimet e përgjithshme në përgjigje të rreziqeve të vlerësuara të anomalive materiale në nivel pasqyrash financiare, dhe për të hartuar dhe kryer procedura të mëtejshme auditimi, natyra, afatet dhe shtrirja e të cilave janë të bazuara, dhe iu përgjigjen rreziqeve të vlerësuara të anomalisë materiale në nivel pohimi.⁶ Përveç kësaj, SNA 330 kërkon që, pavarësisht nga rreziqet e vlerësuara të anomalive materiale, audituesi harton dhe kryen procedura thelbësore për çdo klasë të transaksioneve, tepriç në llogari dhe informacion material të dhënë. Gjithashtu, është e nevojshme që audituesi të shqyrtojë nëse procedurat e konfirmimit nga të tretët do të kryhen si procedura thelbësore auditimi.⁷
- SNA 330 kërkon që sa më i lartë të jetë vlerësimi i rrezikut nga audituesi, aq më shumë evidencë auditimi të besueshme duhet të sigurojë ai.⁸ Për ta bërë këtë, audituesi mund të rritë sasinë e provave ose të marrë evidencë që është më e përshtatshme apo më e besueshme, ose të dyja. Për shembull, audituesi mund të vërë theksin më shumë në marrjen e evidencës drejtpërsëdrejti nga palët e treta ose në marrjen e saj nga një numër burimesh të pavarura. Gjithashtu, SNA 330 tregon se procedurat e konfirmimit nga të tretët mund të ndihmojnë audituesin në marrjen e evidencës së auditimit me nivelin e lartë të besueshmërisë që ai kërkon për t'iu përgjigjur rreziqeve të rëndësishme të anomalive materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve.⁹
- SNA 240 tregon se audituesi mund të përpilojë kërkesa për konfirmim që të marrë informacion shtesë vërtetues në përgjigje të rreziqeve të vlerësuara të anomalive materiale për shkak të mashtrimit në nivel pohimi.¹⁰
- SNA 500 tregon se informacioni vërtetues i marrë nga një burim i pavarur i entitetit, të tilla si konfirmimet nga të tretët, mund të rrisë sigurinë e audituesit që ka nga evidenca ekzistuese e marrë nga regjistrat e kontabilitetit ose nga deklaratimet e bëra nga drejtimi.¹¹

Hyrja në fuqi

4. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

⁶ SNA 330, paragrafët 5-6.

⁷ SNA 330, paragrafët 18-19.

⁸ SNA 330, paragrafi 7(b).

⁹ SNA 330, paragrafi A53.

¹⁰ SNA 240, *Përgjegjësitë e Audituesit në Lidhje me Mashtrimin në Auditimin e Pasqyrave Financiare*, paragrafi A38.

¹¹ SNA 500, paragrafët A8-A9.

Objektivi

5. Objektivi i audituesit, kur përdor procedurat e konfirmimit nga të tretët, është që të hartojë dhe kryejë procedura të tilla për të përftuar evidencë auditimi përkatëse dhe të besueshme.

Përkufizimet

6. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtme kanë kuptimin e dhënë në vijim:
 - (a) Konfirmimi nga jashtë - Evidenca e auditimit e marrë në formën e një përgjigje të drejtpërdrejtë me shkrim që audituesit i jepet nga një palë e tretë (pala konfirmuese), në letër ose në mënyrë elektronike apo edhe përmes një mjeti tjetër.
 - (b) Kërkesë konfirmimi pozitive - Një kërkesë që pala konfirmuese i jep përgjigje të drejtpërdrejtë audituesit duke treguar nëse është dakord ose jo me informacionin në kërkesë, ose duke i dhënë informacionin e kërkuar.
 - (c) Kërkesë konfirmimi negative - Një kërkesë që pala konfirmuese i jep përgjigje të drejtpërdrejtë audituesit vetëm nëse nuk është dakord me informacionin në kërkesë.
 - (d) Mos përgjigje - Dështimi që pala konfirmuese të përgjigjet ose të japë një përgjigje të plotë ndaj një kërkesë konfirmimi pozitive, ose një kërkesë konfirmimi që kthehet pa shkuar në destinacion.
 - (e) Përrjashtim - Një përgjigje që tregon për një dallim midis informacionit që kërkohet të konfirmohet, ose që përfshihet në regjistrat e entitetit dhe informacionit të siguruar nga pala konfirmuese.

Kërkesat

Procedurat e konfirmimit nga të tretët

7. Kur përdoren procedurat e konfirmimit nga të tretët, audituesi duhet të kujdeset për kontrollin mbi kërkesat për konfirmim nga të tretët, duke përfshirë:
 - (a) Përcaktimin e informacionit që duhet të konfirmohet apo kërkohet; (Ref: Paragrafi A1)
 - (b) Zgjedhjen e palës së duhur që konfirmon; (Ref.: Paragrafi A2)
 - (c) Hartimin e kërkesës për konfirmim, duke përfshirë përcaktimin se kërkesat janë bërë siç duhet dhe përmbajnë informacionin e dërguesit për përgjigjet që do t'i dërgohen drejtpërdrejt audituesit; dhe (Ref: Paragrafët A3-A6)

KONFIRMIMET NGA TË TRETËT

- (d) Dërgimin e kërkesave, përfshirë edhe vijimësinë e tyre kur është e mundur, tek pala konfirmuese. (Ref: Paragrafi A7)

Moslejimi nga drejtimi që audituesi të dërgojë një kërkesë konfirmimi

8. Në qoftë se drejtimi refuzon të lejojë audituesin për të dërguar një kërkesë konfirmimi, atëhere audituesi duhet:
- (a) Të hetojë për arsyet e refuzimit nga ana e drejtimit, dhe të kërkojë evidencë auditimi për vlefshmërinë dhe arsyeshmërinë e tyre; (Ref: Paragrafi A8)
 - (b) Të vlerësojë pasojat e refuzimit të drejtimit në vlerësimin e rreziqeve përkatëse të anomalive materiale nga audituesi, duke përfshirë rrezikun e mashtrimit, natyrën, afatin dhe shtrirjen e procedurave të tjera të auditimit; dhe (Ref: Paragrafi A9)
 - (c) Të kryejë procedura alternative auditimi, të parashikuara për të marrë evidencë auditimi të rëndësishme dhe të besueshme. (Ref: Para A10)
9. Nëse audituesi konkludon që refuzimi i drejtimit për ta lejuar që të dërgojë një kërkesë konfirmimi është i paarsyeshëm, ose audituesi është i paafët që të përftojë evidencë auditimi përkatëse dhe të besueshme nga procedurat alternative të auditimit, atëhere ai duhet të komunikojë me personat e ngarkuar me qeverisjen në përputhje me SNA 260 (i rishikuar).¹² Gjithashtu, audituesi përcakton pasojat për auditimin dhe opinionin e tij në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).¹³

Rezultatet e procedurave të konfirmimit nga të tretët

Besueshmëria e përgjigjeve të marra

10. Nëse audituesi identifikon faktorët që ngjallin dyshime në lidhje me besueshmërinë e përgjigjes ndaj një kërkesë konfirmimi, ai duhet të marrë evidencë nga auditimi i mëtejshëm për të hequr këto dyshime. (Ref: Paragrafi A11-A16)
11. Nëse audituesi konstaton se një përgjigje ndaj një kërkesë konfirmimi nuk është e besueshme, ai duhet të vlerësojë pasojat në vlerësimin e rreziqeve përkatëse të anomalive materiale, duke përfshirë rrezikun e mashtrimit, dhe përta i përket natyrës, afatit dhe shtrirjes së procedurave të tjera të auditimit. (Ref: Paragrafi A17)

¹² SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 16.

¹³ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinioni në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

Mos përgjigjet

12. Në rastin e çdo mospërgjigjeje, audituesi do të kryejë procedura alternative auditimi për të marrë evidencë auditimi përkatëse dhe të besueshme. (Ref: Paragrafi A18-A19)

Kur një përgjigje e një kërkesë konfirmimi pozitive është e nevojshme për të patur evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme

13. Nëse audituesi ka përcaktuar se është e nevojshme një përgjigje ndaj një kërkesë konfirmimi pozitive që të ketë evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme, atëherë procedurat alternative të auditimit nuk do të sigurojnë evidencën që ai kërkon. Nëse audituesi nuk ka marrë një konfirmim të tillë, ai duhet të përcaktojë pasojat në auditim dhe në opinionin e tij në përputhje me SNA 705 (i rishikuar). (Ref: Paragrafi A20)

Përrjashtimet

14. Audituesi duhet të hetojë përrjashtimet për të përcaktuar nëse ato janë apo jo tregues të anomalive. (Ref: Paragrafët A21-A22)

Konfirmimet negative

15. Konfirmimet negative sigurojnë një evidencë auditimi më pak bindëse se sa konfirmimet pozitive. Prandaj, audituesi nuk duhet të përdorë konfirmimet negative si procedurë të vetme thelbësore auditimi në trajtimin e një rreziku të anomalive, të vlerësuar materiale në nivel pohimi, nëse nuk plotësohen të gjitha sa më poshtë: (Ref: Paragrafi A23)

- (a) Audituesi ka vlerësuar rrezikun e anomalive materiale të ulët dhe ka marrë evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme në lidhje me efektivitetin operativ të kontrolleve që ka të bëjë me pohimin;
- (b) Popullsia e zërave, që i nënshtrohet procedurave të konfirmimit negativ, përbëhet nga një numër i madh tepricash të vogla dhe homogjene të llogarive, transaksionesh ose kushtesh;
- (c) Pritet që përqindja e përrjashtimeve të jetë e ulët; dhe
- (d) Audituesi nuk është në dijeni të rrethanave ose kushteve që do ta detyronin marrësin e kërkesave për konfirmim negativ t'i shpërfillte ato.

Vlerësimi i evidencës së përftuar

16. Audituesi do të vlerësojë nëse rezultatet e procedurave të konfirmimit nga të tretët sigurojnë evidencë auditimi përkatëse dhe të besueshme, apo nëse është e nevojshme evidencë auditimi shtesë. (Ref: Paragrafët A24-A25)

Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

Procedurat e konfirmimit nga të tretët

Përcaktimi i informacionit që duhet të konfirmohet apo të kërkohet (Ref: Paragrafi 7(a))

- A1. Procedurat e konfirmimit nga të tretët shpesh kryhen për të konfirmuar ose kërkuar informacion në lidhje me tepricat e llogarive dhe elementet e tyre. Gjithashtu, ato mund të përdoren për të konfirmuar kushtet e marrëveshjeve, kontratave, ose transaksioneve midis një njësie ekonomike dhe palëve të tjera, ose për të konfirmuar mungesën e kushteve të caktuara, të tilla si një "marrëveshje më vete."

Përzgjedhja e palës së duhur konfirmuese (Ref: Paragrafi 7(b))

- A2. Përgjigjet për kërkesat për konfirmim sigurojnë evidencë auditimi më të përshtatshme dhe më të besueshme kur këto kërkesa i janë dërguar një pale konfirmuese që audituesi mendon se ka dijeni në lidhje me informacionin që do të konfirmohet. Për shembull, një zyrtar i një institucioni financiar, i cili ka dijeni në lidhje me transaksionet ose marrëveshjet për të cilat është kërkuar konfirmim, mund të jetë personi më i përshtatshëm në këtë institucion nga i cili kërkohet konfirmimi.

Hartimi i kërkesave për konfirmim (Ref: Paragrafi 7(c))

- A3. Hartimi i një kërkesë për konfirmim mund të ndikojë drejtpërdrejt në shpejtësinë e dhënies së përgjigjes për konfirmim, në besueshmërinë dhe në natyrën e evidencës së auditimit të marrë nga përgjigjet.

- A4. Në hartimin e kërkesave për konfirmim duhet të merren parasysh këta faktorë:

- Pohimet e adresuara.
- Rreziqet specifike të identifikuara të anomalive materiale, duke përfshirë rreziqet për mashtrim.
- Formulari dhe paraqitja e kërkesës për konfirmim.
- Eksperienca e mëparshme në auditim ose angazhime të ngjashme.

KONFIRMIMET NGA TË TRETËT

- Metoda e komunikimit (për shembull, në letër, ose formë elektronike apo përmes një mjeti tjetër).
 - Autorizimi i drejtimit ose inkurajimi i palëve konfirmuese për t'i dhënë përgjigje audituesit. Palët konfirmuese mund të jenë të gatshme për t'iu përgjigjur një kërkesë konfirmimi vetëm kur përmban autorizimin e drejtimit.
 - Aftësia e palës konfirmuese për të konfirmuar ose për të siguruar informacionin e kërkuar (për shembull, shuma e faturës individuale kundrejt totalit të tepricës në llogari).
- A5. Në një kërkesë për t'u konfirmuar në mënyrë pozitive nga të tretët, palës konfirmuese i kërkohet që t'i përgjigjet audituesit në të gjitha rastet, si duke treguar se është dakord me informacionin e dhënë, ashtu edhe duke dhënë informacion lidhur me kërkesën. Një përgjigje ndaj një kërkesë konfirmimi pozitive, zakonisht, pritet të japë evidencë auditimi të besueshme. Megjithatë, ekziston rreziku që pala konfirmuese mund t'i përgjigjet kërkesës për konfirmim pa verifikuar nëse informacioni është i saktë apo jo. Audituesi mund ta zvogëlojë këtë rrezik duke përdorur kërkesat për konfirmim pozitive që nuk paraqesin shuma (ose informacion tjetër), por i kërkojnë palës konfirmuese që të japë vetë shumat apo informacionet. Nga ana tjetër, përdorimi i kësaj procedure të quajtur kërkesë për konfirmim “bosh” mund të rezultojë në nivele të ulëta të përgjigjeve, sepse nga pala konfirmuese kërkohet të bëhen përpjekje shtesë për ta plotësuar.
- A6. Përcaktimi që kërkesat janë adresuar ashtu siç duhet përfshin testimin e vlefshmërisë së disa ose të gjitha adresave para dërgimit të tyre.

Vijimësia e kërkesave për konfirmim (Ref: Paragrafi 7(d))

- A7. Audituesi mund të dërgojë një kërkesë konfirmimi shtesë kur përgjigjja për një kërkesë të mëparshme nuk është marrë brenda një kohe të arsyeshme. Për shembull, audituesi mund të dërgojë një kërkesë shtesë apo në vijimësi, pasi të ketë verifikuar përsëri saktësinë e adresës origjinale.

Moslejimi nga drejtimi që audituesi të dërgojë kërkesën për konfirmim

Arsyeshmëria e refuzimit të drejtimit (Ref: Paragrafi 8 (a))

- A8. Një refuzim nga drejtimi për të lejuar audituesin të dërgojë një kërkesë konfirmimi përbën një kufizim në marrjen e evidencës audituese që ai dëshiron të ketë. Prandaj, audituesi kërkohet të shikojë se cilat janë arsyet e këtij kufizimi. Një nga arsyet më të zakonshme është ekzistenca e një mosmarrëveshje ligjore ose negociatave të vazhdueshme me palën e ardhshme konfirmuese, zgjidhja e të cilave mund të ndikohet nga një kërkesë konfirmimi e parakohshme. Audituesi duhet të kërkojë evidencë auditimi që mbështet vlefshmërinë dhe arsyeshmërinë e shkaqeve të refuzimit. Kjo

bëhet për shkak se ekziston rreziku që drejtimi të bëjë përpjekje për të mos e lejuar audituesin të ketë evidencën audituese që mund të zbulojë mashtrimin apo gabimin.

Implikimet për vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale (Ref: Paragrafi 8(b))

A9. Audituesi mund të konkludojë nga vlerësimi në paragrafin 8(b) se do të jetë e përshtatshme të rishikojë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në nivel pohimi dhe të modifikojë procedurat e planifikuara të auditimit në përputhje me SNA 315 (i rishikuar).¹⁴ Për shembull, në qoftë se kërkesa e drejtimit për të mos konfirmuar është e paarsyeshme, kjo përbën një faktor rreziku për mashtrim që duhet të vlerësohet në përputhje me SNA 240.¹⁵

Procedurat alternative të auditimit (Ref: Paragrafi 8 (c))

A10. Procedurat alternative të auditimit të kryera mund të jenë të ngjashme me ato që janë të përshtatshme në rastin kur nuk jepet përgjigje, siç është parashtruar në paragrafët A18-A19 të këtij SNA-je. Gjithashtu, këto procedura duhet të marrin parasysh rezultatet e vlerësimin të bërë nga audituesi sipas paragrafit 8 (b) të këtij SNA-je.

Rezultatet e procedurave të konfirmimit nga të tretët

Besueshmëria e përgjigjeve të marra (Ref: Paragrafi 10)

A11. SNA 500 tregon se kur evidenca e auditimit është marrë nga burime jashtë njësisë ekonomike, mund të ekzistojnë rrethana që ndikojnë në besueshmërinë e saj.¹⁶ Të gjitha përgjigjet e marra përmbajnë disa rreziqe të paragjykit, ndryshimit apo mashtrimit. Rreziqe të tilla ekzistojnë, pavarësisht nëse një përgjigje është marrë në letër, në formë elektronike apo përmes një mjeti tjetër. Faktorët që mund të vënë në dyshim besueshmërinë e një përgjigjeje përfshijnë:

- Rastin kur përgjigjja nuk merret drejtpërdrejt nga audituesi; ose
- Duket se ajo nuk merret nga pala konfirmuese që ishte menduar fillimisht.

A12. Përgjigjet e marra në formë elektronike, për shembull, me postë elektronike ose me faks, përfshijnë rreziqe që lidhen me besueshmërinë, ngaqë vërtetimi i origjinës dhe i autoritetit të atij që jep përgjigje mund të jetë i vështirë për t'u realizuar, ndaj dhe ndryshimet e bëra mund të jetë e vështirë të zbulohen. Një proces konfirmimi i përdorur nga audituesi dhe personat që japin përgjigje, që krijojnë një mjedis të sigurt për përgjigjet e marra në formë elektronike, mund të zvogëlojë këto rreziqe. Nëse

¹⁴ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalive Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*, paragrafi 31.

¹⁵ SNA 240, paragrafi 25.

¹⁶ SNA 500, paragrafi A31.

audituesi është i bindur se një proces i tillë është i sigurt dhe i kontrolluar siç duhet, besueshmëria e përgjigjeve përkatëse është e lartë. Një proces i konfirmimit elektronik mund të përfshijë teknika të ndryshme që kanë të bëjnë me vlerësimin e identitetit të një dërguesi të informacionit në formë elektronike, për shembull, nëpërmjet përdorimit të inskriptimit, nënshkrimit elektronik dixhital, dhe procedurave për të verifikuar vërtetësinë e faqes në internet.

- A13. Nëse një palë konfirmuese përdor një palë të tretë për të koordinuar dhe siguruar përgjigjet për kërkesat për konfirmim, audituesi mund të kryejë procedura për të trajtuar rreziqet që:
- Përgjigjet nuk merren nga burimi i duhur;
 - Personi që jep përgjigje nuk është i autorizuar për ta dhënë atë; dhe
 - Integriteti i dërgimit të përgjigjes mund të jetë kompromentuar.
- A14. Nga SNA 500 kërkohet që audituesi të përcaktojë nëse do të modifikojë apo shtojë procedurat për të hequr dyshimet mbi besueshmërinë e informacionit që do të përdoret si evidencë auditimi.¹⁷ Ai mund të zgjedhë të kontaktojë me palën konfirmuese për të verifikuar burimin dhe përmbajtjen e një përgjigje të një kërkesë konfirmimi. Për shembull, kur një palë konfirmuese përgjigjet me anë të postës elektronike, audituesi mund t'i telefonojë për t'u bindur që në fakt ajo e ka dërguar përgjigjen. Kur një përgjigje, audituesi e ka marrë në mënyrë të tërthortë (për shembull, për shkak se pala e konfirmuese gabimisht ia ka dërguar entitetit në vend që t'ia dërgonte audituesit), atëherë ai mund të kërkojë nga pala konfirmuese t'i përgjigjet me shkrim drejtpërdrejt atij.
- A15. Në vetvete, një përgjigje me gojë për një kërkesë konfirmimi nuk e plotëson përkufizimin e një konfirmimi nga të tretët, sepse ajo nuk është një përgjigje e drejtpërdrejtë me shkrim për audituesin. Megjithatë, pasi merr një përgjigje me gojë për një kërkesë konfirmimi, audituesi, në varësi të rrethanave, mund të kërkojë nga pala konfirmuese t'i përgjigjet drejtpërdrejt me shkrim. Nëse një përgjigje e tillë nuk është marrë, në përputhje me paragrafin 12, audituesi kërkon evidencë tjetër auditimi për të mbështetur informacionin e marrë nga përgjigjia me gojë.
- A16. Një përgjigje e një kërkesë konfirmimi mund të ketë një kufizim gjuhësor përsa i përket përdorimit. Këto kufizime, jo domosdoshmërisht, e bëjnë të pavlefshme besueshmërinë e përgjigjes si evidencë auditimi.

Përgjigjet jo të besueshme (Ref: Paragrafi 11)

- A17. Kur audituesi arrin në përfundimin se një përgjigje nuk është e besueshme, ai mund të ketë nevojë të rishikojë vlerësimin e rreziqeve të anomalive materiale në nivel

¹⁷ SNA 500, paragrafi 11.

pohimi dhe të modifikojë procedurat e planifikuara të auditimit në përputhje me SNA 315.¹⁸ Për shembull, një përgjigje e pabesueshme mund të tregojë një faktor rreziku për mashtrim që kërkon të vlerësohet në përputhje me SNA 240.¹⁹

Mospërgjigjet

A18. Shembuj të procedurave alternative të auditimit, që audituesi mund të kryejë, përfshijnë:

- Për tepricat e llogarive të arkëtueshme – verifikohen arkëtimet specifike të vijueshme në mjete monetare, dokumentacioni i transportit dhe shitjet afër fundit të periudhës.
- Për tepricat e llogarive të pagueshme - verifikohen pagesat e vijueshme në mjete monetare ose korrespondenca nga të tretët, dhe të dhënat tjera, të tilla si dëftesat e pagueshme për mallrat.

A19. Natyra, afati dhe shtrirja e procedurave alternative të auditimit ndikohen nga llogaritë dhe niveli i pohimeve në fjalë. Një mospërgjigje e një kërkesë konfirmimi mund të tregojë për një rrezik të anomalive materiale të paidentifikuar më parë. Në situata të tilla, audituesi mund të ketë nevojë të rishikojë rrezikun e vlerësuar të anomalive materiale në nivel pohimi dhe të modifikojë procedurat e planifikuara të auditimit, në përputhje me SNA 315 (i rishikuar).²⁰ Për shembull, përgjigjet e marra për kërkesa konfirmimi më pak sesa ishte parashikuar, ose në një numër më të madh sesa parashikimi, mund të jenë tregues i një faktor rreziku për mashtrim të paidentifikuar më parë që kërkon të vlerësohet në përputhje me SNA 240.²¹

Kur një përgjigje e një kërkesë konfirmimi pozitive është e nevojshme për të patur evidencë auditimi të mjaftueshme e të përshtatshme (Ref: Paragrafi 13)

A20. Në rrethana të caktuara, audituesi mund të identifikojë një rrezik të vlerësuar të anomalive materiale në nivel pohimi për të cilin një përgjigje për një kërkesë konfirmimi pozitive është e nevojshme që të merret evidencë auditimi e mjaftueshme dhe e përshtatshme. Rrethana të tilla mund të përfshijnë rastet ku:

- Informacioni i disponueshëm për të vërtetuar pohimet e drejtimit gjendet vetëm jashtë entitetit.
- Faktorët specifikë të rrezikut të mashtrimit, të tillë si rreziku që drejtimi të shpërfillë kontrollet, apo rreziku i marrëveshjeve të fshehta ku mund të

¹⁸ SNA 315, paragrafi 31.

¹⁹ SNA 240, paragrafi 24.

²⁰ SNA 315 (i rishikuar), paragrafi 31.

²¹ SNA 240, paragrafi 25.

përfshihen punonjësit dhe/ose drejtimi, e pengojnë audituesin të bazohet në evidencën e marrë nga entiteti.

Përfshirjet (Ref: Paragrafi 14)

- A21. Përfshirjet e vëna në dukje në përgjigjet ndaj kërkesave për konfirmim mund të tregojnë anomalitë ose anomalitë e mundshme në pasqyrat financiare. Kur është identifikuar një anomali, sipas SNA 240, audituesi kërkohet të vlerësojë nëse kjo anomali është tregues i mashtrimit.²² Përfshirjet mund të shërbejnë si një udhëzues për cilësinë e përgjigjeve nga palë konfirmuese të ngjashme apo për llogari të ngjashme. Gjithashtu, ato mund të tregojnë për një mangësi, apo disa mangësi, në kontrollin e brendshëm të entitetit mbi raportimin financiar.
- A22. Disa përfshirje nuk paraqesin anomali. Për shembull, audituesi mund të konstatojë se diferencat në përgjigjet ndaj kërkesave konfirmuese janë për shkak të afatit, matjes, apo gabimeve të të shkruarit në procedurat e konfirmimit të jashtëm.

Konfirmimet negative (Ref. Paragrafi 15)

- A23. Mormarrja e një përgjigjeje për një kërkesë konfirmimi negative nuk shpreh në mënyrë të qartë se pala konfirmuese e synuar e ka marrë kërkesën për konfirmim apo nëse ajo ka bërë verifikimin e saktësisë së informacionit që përmban kërkesa. Prandaj, mungesa e një përgjigjeje për konfirmime negative nga pala konfirmuese përbën, në mënyrë të konsiderueshme, një evidencë auditimi më pak bindëse sesa në rastin e përgjigjes ndaj një kërkesë konfirmimi pozitive. Gjithashtu, ka më tepër mundësi që palët konfirmuese të përgjigjen duke treguar mospajtimin e tyre me një kërkesë konfirmimi kur informacioni në të nuk është në favorin e tyre, dhe më pak gjasa për t'u përgjigjur ndryshe. Për shembull, mbajtësit e llogarive të depozitave bankare ka më tepër mundësi të përgjigjen në qoftë se ata besojnë se teprica në llogarinë e tyre është nënvlerësuar në kërkesën për konfirmim, por ka më pak mundësi të përgjigjen, kur ata besojnë se teprica është mbivlerësuar. Prandaj, dërgimi i kërkesave për konfirmim negative në mbajtësit e depozitave bankare mund të jetë një procedurë e dobishme në shqyrtimin nëse këto teprica mund të jenë nënvlerësuar, por nuk ka gjasa të jetë efektiv nëse audituesi është duke kërkuar evidencë në lidhje me mbivlerësimin.

Vlerësimi i evidencës së përfshirjet (Ref: Paragrafi 16)

- A24. Gjatë vlerësimit të rezultateve të kërkesave individuale të konfirmimit të jashtëm, audituesi mund t'i kategorizojë rezultatet e tilla si vijon:
- (a) Një përgjigje nga pala konfirmuese e duhur që tregon se është dakord me informacionin e dhënë në kërkesën e konfirmimit, ose duke dhënë informacionin e kërkuar pa bërë përfshirje;

²² SNA 240, paragrafi 36.

KONFIRMIMET NGA TË TRETËT

- (b) Një përgjigje që gjykohet jo e besueshme;
- (c) Një mospërgjigje;
- (d) Një përgjigje që tregon një përjashtim.

A25. Vlerësimi që bën audituesi, pasi merr parasysh dhe procedurat e tjera të auditimit që mund të ketë kryer, mund ta ndihmojë atë për të arritur në përfundimin nëse është marrë evidencë auditimi e mjaftueshme dhe e përshtatshme apo është e nevojshme evidencë nga auditimi i mëtejshëm, siç kërkohet nga SNA 330.²³

²³ SNA 330, paragrafët 26-27.